



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Gouvernement

Zyra e Kryeministrit - Kancelarija Premijera- The Prime Minister Office

Në bazë të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtaret Publik, neni 39 (1,2,3, 4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Zyra e Kryeministrit shpallë:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar:

Titulli i Grupit:	Specialist Ligjor
Titulli i pozitës së punës :	Zyrtar/e i/e lartë për legjislacion dhe vlerësim të përshtatshmërisë ligjore të akteve ligjor
Klasa e pozitës :	Profesional 1
Koeficienti/ paga :	I13-5.7
Nr. i kërkuar :	1
Data e njoftimit :	13/02/2024
Afati për aplikim :	14 /02/2024 - 14/03/2024
Institucioni:	Zyra e Kryeministrit
Departamenti :	Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm
Divizioni :	Divizioni i mbikëqyrjes dhe koordinimit të inspektimeve
Vendi Punës :	Prishtinë
Nr. i Referencës:	RN00013317
Kodi:	RPC0006856



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Identifikon, përcjell, vlerëson, ofron rekomandime në lidhje me politikat e iniciuara nga ministritë përkatëse dhe siguron përputhshmërinë e tyre me ligjin e inspektimeve;
2. Identifikon, përcjell, vlerëson, jep rekomandime në lidhje me projektligjet dhe projekt aktet nënligjore e iniciuara nga ministritë përkatëse dhe siguron përputhshmërinë e tyre me ligjin relevant të inspektimeve;
3. Merr pjesë në hartimin dhe zhvillimin e legjislacionit dhe akteve tjera juridike, sipas kërkesave të ministrive përkatëse;
4. Bën përgatitjen e opinioneve dhe këshillave ligjore për ZIP, inspektoratet qendrore dhe njësitë e inspektimeve dhe organeve tjera
5. Harton projekt marrëveshje, projektvendimeve dhe projekt akteve të tjera sipas kërkesave të ZIP;
6. Bashkëpunon dhe bashkërendon aktivitetet me njësitë tjera brenda ZKM për aktivitetet që ndërlidhen me fushën e legjislacionit;
7. Monitoron legjislacionin e inspektimeve dhe raporton zbatimin e tij në baza të rregullta kohore;
8. Përcjellë mbarëvajtjen dhe ecurinë e procedurave për hartimin dhe procedimin e projekt akteve juridike për miratim në Qeveri.
9. Ofron udhëzime juridike dhe shërbime këshilluese;
10. Kryen detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme dhe të ligjshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

2. Kushtet e përgjithshme për pranimin në detyrë sipas nenit 9 të LZP-së:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në Juridik

Kualifikime të posaçme formale:

Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës;



4. Njohurit , Aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës, përpilimit të projekt akteve juridike, hartimin e shkresave dhe komunikimi dhe përfaqësimi;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe në formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi në zgjidhjen e problemeve për çështje teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës;
- Cilësi gjatë kryerjes së detyrave në fushën profesionale;
- Aftësi për tu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore dhe zgjidhjes së problemeve;
- Aftësi për të bërë vlerësime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Njohuri në programet e Microsoft Office;
- Njohja e gjuhës angleze është e preferueshme;
- Të jetë energjik dhe në gjendje të punojë me orar fleksibil dhe trysni kohe, të ketë etikë në punë dhe integritet të lartë pune.

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre

- Kopjen e diplomës universitare me të dhëna nga institucionet arsimore, dëshminë e nostrifikimit për diplomat e fituar jashtë vendit.
- Dëshmi për përvojën e punës e lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë. Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet nëse referencat e përvojës, mbështeten me aktet përkatëse noteriale.
- Së paku njërën nga dëshmitë: dëshminë për kryerjen e obligimeve mbi të ardhurat personale për punëtorin ose dëshminë mbi pagesën e kontributeve pensionale pranë organit kompetent;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve.
- Kopjen e letërnjoftimit /Pasaportës e lëshuar nga Republika e Kosovës.
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për zyrtaret publik dhe ata që kanë punuar në sektorin publik, ndërsa kandidatët jashtë sektorit publik- ofrojnë deklaratën me shkrim të vetë-nënshkruar).

6. Data e daljes së rezultateve dhe vlerësimi paraprak

- Lista e kandidateve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë të shpallet me së largu deri më datën 29 /03/2024 , në portalin e rekrutimit elektronik(<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Kriteret specifike shtesë

- nuk ka

8.Mënyra e vlerësimit të kandidatëve /aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë



09. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatet

- Përmes e-mailit dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidateve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatet pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Kandidati përmes aplikimit deklaron dhe mbanë përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohet nga shpallja e procedurës së rekrutimit.

Bazuar në nenin 14 Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për procedurën e pranimit në Shërbimin Civil, NJBN pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, bënë verifikimin përfundimtar para emërimit të plotësimit të kriterëve të aplikimit nga kandidati dhe kërkon kandidatit paraqitjen e dokumenteve që vërtetojnë plotësimin e kriterëve në origjinal apo të njësuara me origjinalin.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP

